



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME  
E PRONËSISË INDUSTRIALE

(DPPI)

Nr. Prot. 354, datë 27.01.2025

BASHKIA LEZHË

Nr. Prot. 577, datë 27.01.2025

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

### NDËRMJET

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE

DHE

BASHKISË LEZHË

Lidhet kjo Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet palëve të mëposhtme:

1. Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale , me adresë: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Prona nr. 33, ish Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Komanduar, Znj. Maria Solis.

dhe

2. Bashkisë Lezhë me adresë: Lagjja “Skenderbeg”, Sheshi “Gjergj Kastrioti” 4501 Lezhë, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, Z. Pjerin Ndreu.

(veçmas do të quhen si “**Pala**” dhe bashkarisht si “**Palët**”)

#### **MEQENËSE:**

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale është një agjenci autonome që siguron dhëni dhe mbrojtjen e objekteve të Pronësisë Industriale, në fushat e shpikjeve dhe modeleve të përdorimit, markave tregtare dhe të shërbimit, disenjove industriale, treguesëve gjeografikë, topografike dhe qarqeve të integruara.

Drejtoria Përgjithshme e Pronësisë Industriale, është një agjenci autonome nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për ekonominë. Veprimtaria e saj përcaktohet dhe rregullohet me Ligjin nr. 9947 dt. 07/07/2008, "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar dhe ligjin 8488 datë 13.05.1999 "Për Mbrojtjen e Topografive të qarqeve të integruara.

DPPI ka mision nxitjen e zhvillimit të Pronësisë Industriale duke përkrahur inovacionin, sipërmarrjen dhe duke nxitur promovimin e partneriteteve profesionale.

Gjithashtu, DPPI shërben si katalizator për zhvillimin e industrisë nëpërmjet mbrojtjes së pronësisë industriale.

DHE

#### **Bashkia Lezhë**

Lezha, qytet turistik që pasuron trashëgiminë unike historike dhe kulturore, me ekonomi në rritje e biznes inovator e konkurrues, me lidhje të shpejta e zhvillim urban e mjedisor të qëndrueshëm, qytet me komunitete dinamike, që frymëzon progres e krijimtari e që ofron dije të avancuar e mirëqenie për të gjithë. Qyteti i Lezhës flet për një histori të pasur: monumentet e kulturës, objektet e kultit, monedhat, gjeljet arkeologjike, dokumentat e shkruara, ngjarje e figura të shquara dhe një trashëgimi e madhe kulturore, folklorike, veshje e etnografike etj. Janë dëshmi për të kaluarën e qytetit 2400 vjeçar. Kjo është pasuri e brezave dhe përbën detyrimin kundrejt të shkuarës e së ardhmes për t'i mbajtur dhe për t'i përcjellë ato me vlerat që mbartin drejt së ardhmes.

Misioni i Bashkisë Lezhë është të sigurojë një qeverisje të efektshme, në një nivel sa më afër qytetarëve.

Ndër synimet tona në planin strategjik për periudhën në vazhdimësi është përcaktimi i një vizioni të ri, i një filozofie që ndërthur natyrshëm përvojën tashmë të pasur me arritjet më të larta të standardeve bashkëkohore, të krahasueshme këto me rajonin e më gjerë. Pauria me vlera që qyteti i Lezhës, i disponon, nuk duhet të konsiderohen thjesht si relike apo monumente në vete, por edhe si resurse e mundësi të mëdha për zhvillimin e turizmit kulturor e historik, si pjesë e të ardhmes ekonomike.

Marrë në konsideratë sa më lartë, palët bien dakord për kushtet dhe afatet si më poshtë:

**Neni 1**  
**Objekti**

Objekti i kësaj marrëveshjeje është bashkëpunimi mes palëve për:

- a) Rritjen e ndërgjegjësimit të biznesit për të drejtat që ata gëzojnë në lidhje me markën tregtare dhe të shërbimit, disenjot industriale apo treguesin gjeografik të regjistruar.
- b) Përgatitjen e materialeve promovuese, fletë-palosjeve, broshurave, të cilat do të vendosen në mjediset e Bashkisë Lezhë.

**Neni 2**  
**Qëllimi**

Me qëllim realizimin e objektit të kësaj marrëveshje, palët angazhohen në realizimin e aktiviteteve të mëposhtme:

- a) Përgatitjen e materialeve informuese dhe promovuese;
- b) Zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta si konferanca, takime me sektorin vendas, trajnime të ndryshme që kanë për qëllim ndërgjegjësimin e biznesit për rëndësinë e Pronësisë Industriale;
- c) Vendosjen e materialeve promovuese në mjediset e Bashkisë Lezhë në lidhje me informimin e bizneseve me anë të fletë-palosjeve për Pronësinë Industriale;
- d) Tryeza të përbashkëta midis aktorëve kryesorë të tregut që operojnë në fushat e PI-së;
- e) Çështje të tjera me interes të përbashkët;

**Neni 3**  
**Detyrimet e Palëve**

Në realizimin e aktiviteteve të parashikuara në këtë marrëveshje:

- a) DPPI merr përsipër të vërë në dispozicion të Bashkisë Lezhë: materialet informuese, specialistët dhe ekspertët që do të ofrojnë seminare apo trajnime për biznesin në fushën e Pronësisë Industriale;
- b) DPPI merr përsipër të bëjë trajnime për personelin e Bashkisë Lezhë në fushën e Pronësisë Industriale;
- c) Bashkia Lezhë merr përsipër të organizojë, të koordinojë, takimet me biznesin lokal prodhuesit e zonës, të informojë në lidhje me identifikimin dhe mbrojtjen e këtyre produkteve;
- d) Bashkia Lezhë merr përsipër të ofrojë mjedisin për takimet që do të zhvillohen, stendat për panaire dhe materialet promovuese;

**Neni 4**  
**Afati i Marrëveshjes**

1. Kjo marrëveshje nënshkruhet për një afat të pacaktuar.
2. Përbajtja e saj mund të ndryshohet nëpërmjet komunikimeve me shkrim mes palëve.
3. Në rast shfuqizimi të kësaj marrëveshjeje, palët duhet të njoftojnë njëra tjetrën paraprakisht me shkrim të paktën **60** ditë përpëra zgjidhjes së saj, mundësish duke parashtuar dhe arsyet përkatëse.

**Neni 5**  
**Monitorimi i zbatimit**

Me qëllim në përbushjen e objektit dhe qëllimit të kësaj marrëveshje DPPI merr përsipër të përgatisë një raport vlerësues çdo 6 muaj nga data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes.

Raporti vlerësues do t'i paraqitet për miratim palës tjetër pasi ky raport të jetë diskutuar më parë në takimin e përbashkët mes përfaqësuesve të të dyja palëvë që mblidhet me këtë qëllim.

**Neni 6**  
**Dispozita finale**

Marrëveshja hartohet dhe pranohet nga palët, duke nënkuptuar se asnjë pjesë e tij nuk është në tejkalim ose kundërshtim të dispozitave përkatëse ligjore mbi të cilat palët mbështesin ushtrimin në funksion dhe kompetencave të tyre.

Palët zotohen të zbatojnë vullnetarisht dhe në kushte mirëbesimi këtë marrëveshje. Çdo mosmarrëveshje do të zgjidhet me mirëkuptim.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi nënshkruhet sot më datë 27/01/2025, në 2 (dy) kopje origjinale me vlerë të njëjtë, një për secilën palë dhe hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga të dyja palët

**PALËT**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME  
E PRONËSISË INDUSTRIALE  
(DPPI)**

Përfaqësuar nga:

Znj. MARIA SOVIS

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM I KOMANDUAR**

4



**BASHKIA LEZHË**

Përfaqësuar nga:

Z. PJERIN NDREU

